



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE KURBIN**

**KERKESE**

**(Per caktimin e mases se sigurimit pasuror)**

E Prokurorise se rrethit gjyqesor Kurbin, e perfaqesuar nga Prokurore **AJOLA PRENCI**

**OBJEKTI:** Kerkohet caktimi i mases se sigurimit pasuror te “sekuestros preventive”

**BAZA LIGJORE:** Neni 274/2 te KPrP.

Me daten 15.03.2017 Prokuroria e rrethit gjyqesor Kurbin ka regjistruar procedimin penal me numer 100, mbi bazen e akteve te ardhura nga Drejtoria e Policise se Qarkut Lezhe, me objekt vepren penale te “Pastrimit te produkteve te vepres penale ose te veprimtarise kriminale” te parashikuar nga neni 287 i K.P.

**Nga aktet qe ndodhen ne dosjen hetimore rezulton:**

Nga ana e Drejtorise per Hetimin e Krimin Ekonomik e Financiar ne Drejtorine e Policise se Shtetit eshte grumbulluar informacion per nje rast te dyshimte per “Pastrim te produkteve te vepres penale ose te veprimtarise kriminale”, vepere penale e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, nga ana e shtetases **Emanuela Reçi**.

Drejtoria per Hetimin e Krimin Ekonomik e Financiar disponon informacion ne lidhje me shtetases **Emanuela Xhaferr Reçi**, e datelindjes 27.06.1991, kun e emer te saj rezultuan transaksione ne vlera te larta dhe me anomali. Nga verifikimet e kryera ne emer te shtetases **Emanuela Reçi** dhe familjarëve te saj: **Xhaferr Adem Reçi**, i datelindjes 20.08.1952; **Make Ramazan Reçi**, i datelindjes 23.03.1958; **Xhelil Xhaferr Reçi**, i datelindjes 30.04.1984; **Alfons Xhaferr Reçi**, i datelindjes 27.06.1991; **Mirela Xhaferr Reçi**, i datelindjes 15.10.1978; rezultuan:

- Transaksione (derdhje, tërheqje ) të raportuara nga Banka Union
- Nuk rezultuan biznese të regjistruara.

Nga verifikimi i kryer në Bankën Union:

Në emër të shtetases **Emanuela Reçi** rezultojnë:

**Transaksione të kryera në EURO :**

- Më datën 07.10.2015, ka depozituar 7.000 EUR.
- Më datën 16.10.2015, ka tërhequr 2.000 EUR.
- Më datën 02.11.2015, ka depozituar 10.000 EUR.

- Po më datën 02.11.2015, ka përfituar 5.000 EUR nga Alfons Reçi.
- Po më datën 02.11.2015, ka këmbyer 20.000 EUR dhe i ka transferuar në llogarinë në Lekë.
- Më datën 25.11.2015, ka depozituar 10.000 EUR.
- Në datë 11.01.2016, ka depozituar 1.000 EUR.
- Në datat 18.01.2016 dhe 02.02.2016, ka depozituar 5.500 EUR.

*(shumat e depozituara janë të vendosura në depozita me afat).*

- Në datë 08.02.2016, llogaria është kredituar me 13.000 EUR nga këmbimi *(transferuar nga llogaria në Lekë)*
- Në datë 01.03.2016, ka tërhequr 3.000 EUR.
- Në datë 13.05.2016, ka tërhequr 2.000 EUR.
- Në datë 18.05.2016, ka transferuar 24.930 EUR në favor të Make Reçi në Itali me përshkrimin *“for buying a flat for her parents, Parma”*.
- Në datë 01.09.2016 ka përfituar 3.000 EUR nga Make Reçi.
- Në datë 16.11.2016, ka depozituar 20.000 EUR.
- Në periudhën shtator-dhjetor 2016 ka tërhequr 1.300 EUR.
- Në datë 16.01.2017, ka depozituar 20.000 EUR.
- Në janar 2017, ka tërhequr 400 EUR.
- **Gjendja në llogari rrjedhëse është 1.300 EUR.**
- **Gjendja në llogari depozite është në total 40.000 EUR.**

Lidhur me transfertën në favor të Make Reçi në Itali, në bankë është depozituar kontrata për blerjen e një apartamenti banimi me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup>, me çmim 35.000 mijë euro, nga shtetase Gabriella Spotti (shitëse), më datën 23.06.2016.

#### **Transaksione të kryera në Lekë:**

- Në datë 2013 ka depozituar 1.000.000 Lekë.
- Në periudhën janar-prill 2014 ka tërhequr 801.500 Lekë.
- Në datë 03.06.2014 ka depozituar 450.000 Lekë.
- Në periudhën qershor-gusht 2014 ka tërhequr 530.000 Lekë.
- Në datë 13.10.2014 ka depozituar 210.000 Lekë.
- Në datë 25.11.2014 ka depozituar 200.000 Lekë.
- Në datë 09.01.2015 Xhaferr Reçi (i ati) ka depozituar 1.450.000 Lekë.
- Në datë 11.02.2015 llogaria është kredituar me 2.780.000 Lekë nga këmbimi *(përshkruar më sipër të cilat i ka vendosur në depozitë me afat).*
- Në periudhën mars-qershor 2015 ka kryer 17 tërheqje cash në vlerë totale 1.986.500 Lekë.
- Në datë 07.10.2015 ka depozituar 40.000 Lekë.
- Në datat 23.05.2016 dhe 01.09.2016 ka depozituar respektivisht 310.000 Lekë dhe 20.000 Lekë.
- Në periudhën janar-korrik 2016 ka kryer 29 tërheqje cash në vlerë totale 1.250.000 Lekë.
- Në datë 08.02.2016 llogaria ka këmbyer dhe transferuar 1.872.500 Lekë në llogarinë e saj në EUR *(përshkruar më sipër).*
- Gjendja në llogari rrjedhëse është 5.470 Lekë.

#### **Në emër të Make Reçi, rezulton se:**

- Në datë 08.02.2016 ka depozituar 10.000 EUR pranë Union Bank.

- Në periudhën 09.08.2016-01.09.2016 ka tërhequr në total 8.000 EUR.
  - Në datë 01.09.2016 ka transferuar 3.000 EUR në favor të Emanuela Reçi (*përshkruar dhe më sipër*).
  - Gjendja në llogari zero.
- Në emër të shtetasit **Alfons Reçi**, rezulton se:
- Në datë 23.02.2015 ka depozituar 10.000 EUR pranë Union Bank.
  - Në datë 17.08.2015 ka tërhequr shumën prej 5.000 EUR.
  - Në datë 12.11.2015 ka transferuar 5.000 EUR në favor të Emanuela Reçi. (*përshkruar dhe më sipër*).
  - Gjendja në llogari zero.

Sipas informacionit të marre ne lidhje me shtetasin Xhelil Reçi (vëllait të Emanuela Reçi) rezulton se:

- Në prill të vitit 2011, shtetasi shqiptar Xhelil Reçi, 27 vjeç, është arrestuar dhe si pjesë e një grupi shpërndarës droge (nga gjendja civile identifikohet vetëm një shtetas si Xhelil Reçi). Xhelil Reçi, rezultoi anëtar i kartelit i cili merrej me shpërndarjen e drogave si: hashash, heroinë dhe kokainë.
- Në maj të të njëjtit vit, në emër të shtetasit Xhelil Reçi rëndon dhe akuza e Përndjekjes, kanosjes dhe rrahjes ndaj ish bashkëjetueses së tij.

Duke marrë në konsideratë:

- 
- Precedentët penalë të shtetasit Xhelil Reçi dhe shumat e larta të transaksioneve financiare të kryera nga familjarët e tij,
- Të dhënat lidhur me përfshirjen e shtetasit Xhelil Reçi (vëllait të shtetases Emanuela Reçi), në aktivitetin kriminal të trafikimit të lëndëve narkotike;
- Derdhje-tërheqje të shpeshta dhe në vlera të larta të kryera nga Emanuela Reçi; lindin dyshime se ndodhemi përpara një rasti të dyshimtë për "Pastrim parash", në lidhje me burimin e fondeve, për rrjedhojë bazuar në Ligjin nr. 9917 datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar, nga informacionet që kemi, rezulton se është vendosur bllokimi i përkohshëm i transaksioneve në Bankën Union.

Nga informacionet që ka Drejtoria për Hetimin e Krimin Ekonomik e Financiar në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, rezulton se Drejtoria e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave ka nxjerrë urdhërin nr. 22 (511/1 Prot.) datë 13.03.2017, për bllokimin e përkohshëm të të gjitha transaksioneve dhe veprimeve financiare në bankën Union për një periudhë prej 72 orësh si dhe të llogarive dhe për llogari të shtetases Emanuela Xhaferr Reçi, e datëlindjes 27.06.1991. Në përgjigjen që duhet të dërgohet nga Banka për DPPP duhet të saktësohen llogaritë e bllokuara dhe shumat përkatëse.

Nisur nga sa me sipër ka dyshime të arsyeshme se pasuria e lartpërmendur është produkt i një të ardhurave të siguruar nga një veprimtari kriminale e shtetasit Xhelil Reçi dhe familjareve të tij, sic edhe e trajtuam me lart. Si e theksuam me lart në lidhje me shtetasin Xhelil Reçi ka të dhëna policore për përfshirjen e tij në veprimtari kriminale dhe pasuritë e bllokuara pranë Union Bank janë rrjedhojë e kësaj pasurie.

Ne lidhje me kete pasuri ekziston dyshimi i arsyeshem se disponimi i lire i saj nga shtetasi Xhelil reci apo te aferm te tij mund te sjelle pasoja ne drejtim te tjetersimit, zhdukjes apo ketyre pasurive.

**Faktet e lartpermendura dhe kerkesen tone per mase sigurimi e bazojme ne keto akte:**

- 1- Urdher me numer 22, te dates 13.03.2017 te Drejtorise se Pastrimit te Parave.
- 2- Te dhena te sistemit TIMS per shtetasen Emanuela Reci.
- 3- Te dhena te sistemit TIMS PER SHTETASIN Xhelil Reci.
- 4- Printim i sistemit per lidhjet familjare.

Persa me siper bazuar ne nenet 274/2 te K.Pr.P. dhe 36 te K.P. nga Gjykata e Rrethit gjyqesor Kurbin

#### **KERKOJME:**

Vendosjen e mases se sigurimit pasuror te sekuestros prevendive mbi te gjitha llogarite bankare te cilat rezultojne ne emer te shtetasve Xhefer Reci, Make Reci, Mirela Reci, Xhelil Reci, Alfons Reci, Emanuela Reci prane Bankes Union

**PROKURORE E CESHTJES**

**Ajola PRENÇI**

